



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture,  
Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports  
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale  
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo



Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosijen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjit nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, palët nënshkruese janë pajtuar për të nënshkruar këtë:

## MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

“Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së në Llaushë-Skenderaj”

### NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale e përfaqësuar nga  
z.Bislim Zogaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë

dhe

Komuna e Skenderajt e përfaqësuar nga z. Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt

### Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit nënshkruhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe të Komunës së Skenderajt, me qëllim të përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësisive të financimit të projektit të përbashkët me titull: “Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së në Llaushë-Skenderaj”.

### Neni 2

### Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

1. Projekti “Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së në Llaushë-Skenderaj”, sipas planifikimit buxhetor ka koston financiare në total prej 147 000.00€ (euro).

2. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerën prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro), nga kodi 18534 i paraparë në buxhetin e Agjencisë për vitin 2023.

3. Komuna e Skenderajt financon këtë projekt në vlerën prej 47.000.00€ (euro), nga kodi 43870, i paraparë në buxhetin e Komunës së Skenderajt, për vitin 2023.

### **Neni 3**

#### **Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale**

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në pajtim me ligjin dhe këtë marrëveshje, zoton mjetet për projektin e paraparë në nenin 2 të kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e dërgon në Komunën e Skenderajt për realizimin e projektit.

2. Pagesa për financimin e projektit “Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së në Llaushë-Skenderajt” nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale do të ekzekutohet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Skenderajt.

3. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale mund të caktoj një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit “Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së në Llaushë-Skenderajt”, i cili do t’i raportojë Agjencisë.

### **Neni 4**

#### **Obligimet e Komunës**

1. Komuna e Skenderajt obligohet që për projektin e “Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë publike të UÇK-së në Llaushë-Skenderajt” në pajtim me ligjin të zhvilloj procedurat që kanë të bëjnë me procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

2. Komuna e Skenderajt emëron Menaxherin dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

3. Komuna e Skenderajt është e obliguar që të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për të gjithë hapat e realizimit të projektit.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Skenderajt përfundon me realizimin e projektit.

**Neni 6**  
**Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes**

1. Palët nënshkruese, zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast të kontestit eventual apo paqartësie për zbatimin e kësaj marrëveshje, pajtohen që përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim të gjendet zgjidhje përkatëse, e në të kundërtën pajtohen që për zgjidhjen e kontestit t'i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Për plotësimin dhe ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese pajtohen që të ndjekin rrugën e njëjtë si për nënshkrimin e marrëveshjes bazë.

**Neni 7**  
**Pronësia e projektit**

1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky projekt i paraparë sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të regjistrohet në pronësi të Komunës së Skenderajt.
2. Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës së Skenderajt në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

**Neni 8**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë identik dhe secila palë nënshkruese merr nga dy ekzemplarë.
2. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

**PALËT NËNSHKRUESE TË MARRËVESHJES**

**Bislim ZOGAJ**  
  
**Drejtor Ekzekutiv**  
Agjencia për Menaxhimin  
e Monumenteve dhe  
Komplekseve Memoriale



**Badil NURA**  
  
**Kryetar i Komunës**  
Komuna e Skenderajt



Datë: 12/05/2023